



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 1550 Prot
Dt. 07.04.25



Nr. 247/1
prot.

Shkodër, më 07.04.2025

Lënda: Mbi Vendimet Nr. 21, 22, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronjat "n", neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", dokumentacioni i mbledhjes të këshillit bashkiak bashkëlidhur u njoh me vendimet Nr. 21, 22, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës "Për ngritje komisioni strehimi me emra specifik dhe pranim në qendrën e përkujdesjes për të moshuar "Besa" zj. L.S ", akte me karakter jo normativ.

Emrat e përfitueseve (nominalisht) nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja "a" e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda
Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK
VENDIM**

Nr. 21 datë 26.03.2025

**“Për miratimin e ndryshimit të VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR 80 dt.30.10.2023
për ngritjen e Komisionit të Strehimit”**

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar, neni 2 pika 51; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Sektorit të Strehimit Social , dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI

1. Ndryshimin e VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR.80 dt.30.10.2023.
2. Miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit, me përbërje si më poshtë:
 - Dajana Lleshi – Kryetar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Silvana Ismailaj - Zv/ Kryetar, Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
 - Marian Marku – Anëtar, Sektori i Buxhetit dhe Financës
 - Indrit Kurtbegu -Anëtar, Sektori i Investimeve.
 - Aurela Deda - Anëtar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Suela Domnori- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
 - Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar)

Kryetar Këshilli

Ervis Shimaj

Sekretar Këshilli

Ardian Çelepja



Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me Datë 02.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 06 datë 19.03.2025

“Për miratimin e ndryshimit të VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR 80 dt.30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit”

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar, neni 2 pika 51; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Sektorit të Strehimit Social, Kryetar i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të :

VENDOSI

1. Ndryshimin e VKB NR.33 dt.28.04.2023 dhe VKB NR.80 dt.30.10.2023.
2. Miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit, me përbërje si më poshtë:
 - Dajana Lleshi – Kryetar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Silvana Ismailaj - Zv/ Kryetar, Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
 - Marian Marku – Anëtar, Sektori i Buxhetit dhe Financës
 - Indrit Kurtbegu -Anëtar, Sektori i Investimeve.
 - Aurela Deda - Anëtar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Suela Domnori- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
 - Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”)

KRYETARI
Kristian Shkreli

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/KRYETARI
Aleksandra Gjoni



Konceptoi: E.Gjeca
Pranoi: D.Lleshi
Miratoi: R.Luzaku
Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr. — prot.

Vau Dejës, me 19/03 /2025

RELACION

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ;në zbatim të ligjit nr 22/2018 “ Për strehimin social”i ndryshuar; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, u krye ndryshimi i pjestarëve të Komisionit të Strehimit për shkak të largimit të disa anëtarve nga detyrat funksionale në institucionet përkatëse.

Qëllimi është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit, për një veprimtari më efëiente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Ky Komision në përputhje me normat juridike, duhet që, sa herë në Bashkinë Vau Dejës ka në zbatim një program social strehimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlerësimin teknik sipas sistemit të pikëzimit të miratuar në Këshillin Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe efëiencës së tij si organ kolegjal përballë aplikuesve.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni i Strehimit trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha dosjet e aplikantëve në programet e strehimit social.

Konceptoi: **E.Gjeçaj**